

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-064/13

**Prishtinë,
16 korrik 2014**

Në çështjen juridike civile të:

H.L

Pala ankuese

kundër.

S.B.P

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova and Gyltene Sylejmani, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112-2011, të datës 22 qershor 2011 (lënda është regjistruar në AKP me numër KPA44058) , pas shqyrtimit të mbajtur më 16 korrik 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM:

1. Pranohet si e bazuar ankesa e H.L.
2. Anullohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112-2011, i datës 22 qershor 2011, dhe lënda kthehet në KKPK për rishqyrtim.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 qershor 2007, S.B.P ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar konfirmimin e së drejtës së tij pronësore mbi ngastrën 1 083, me sipërfaqe të përgjithshme prej 31 ari 12 m², arë e klasës së 4-të, zona kadastrale Gërmovë, sipas fletës poseduese nr. 31, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të komunës së Vitisë.
2. Përmes vendimit grupor KPCC/D/A/19/2008 të datës 20 qershor 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) e ka pranuar kërkesën në një procedurë jokontestuese. Kërkesa është pranuar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës, B.V.P. Megjithatë, ky vendim është kthyer më 12 maj 2010 sepse njoftimi i kërkesës është bërë në një lokacion të gabueshëm.
3. Më 13 korrik 2010, një njoftim i kërkesës është bërë në Gazetën për njoftime të AKP-së dhe në BULETININ e Zyrës për Çështje Pronësore të UNHCR-it. Gjithashtu një njoftimi është vendosur në kioskën në hyrje/dalje të fshatit në Gërmovë në Viti.
4. Më 22 qershor 2011, me vendimin grupor KPCC/D/A/112/2011, KKPK-ja ka pranuar kërkesën në emër të paraqitësit të kërkesës, S.B.P, pas një procedure jokontestimore. Në atë kohë është vërtetuar se B.V.P ka vdekur më 1 qershor 2000.
5. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar S.B.P më 21 shkurt 2012.
6. Më 24 janar 2013, H.L ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së, duke pretenduar se ai ishte një nga palët e interesuara. Ankesa i është dorëzuar bashkëshortes së S.B.P, V.P, më 6 gusht 2013. Ajo ka paraqitur përgjigjen e saj në ankesë me 14 gusht 2013. Bashkë me përgjigjen e saj ajo paraqiti një njoftim të vdekjes, ku thuhet se S.B.P ka vdekur më 23 Tetor 2010.
7. Gjykata Supreme ka pranuar lëndën më 19 nëntor 2013. Më 21 nëntor 2013, Gjykata Supreme u ka dhënë urdhër palëve, duke kërkuar përgjigje në pyetjet specifike kryesisht në lidhje me posedimin e pronës gjatë periudhës së konfliktit të armatosur në vitin 1998/1999. H.L ka paraqitur përgjigjen e tij ndaj urdhrit më 17 dhjetor 2013. Në kohën kur është marr aktgjykimi, urdhri nuk i ishte dorëzuar V.P.

Pretendimet e palëve

8. H.L. deklaron se ai nuk ka marr pjesë në procedurë në KKPK, sepse nuk ka qenë në dijeni rreth kërkesës apo procedurës. Ai u njoftua për herë të parë rreth kërkesës atëherë kur e pranoi vendimin e KKPK-së.
9. H.L pretendon ta ketë blerë ngastrën nr. 1 083 nga V.B.P përmes kontratës me shkrim mbi blerjen të datës 3 prill 1989. Çmimi i blerjes ishte 50 400 DEM. H.L thotë se vazhdimisht ka qenë i interesuar në bartjen e ngastrës në emrin e tij, por kur e bleu ngastrës kjo nuk ishte e mundur për shkak të ligjeve diskriminuese që ndalonin bartjen e pronave të serbëve në emër të shqiptarëve.
10. Sipas H.L, V.P, e ka konfirmuar transaksionin, por sidoqofte ajo pretendon se e ka trashëguar pronën e cila ishte e regjistruar në emër të vjehrrit të saj.
11. Gjykata Komunale në Viti mori një aktvendim të përkohshëm më 7 dhjetor 2012 duke urdhëruar V.P që të mos e tjetërsojë apo të lidh ndonjë kontratë për patundshmërinë lidhur me ngastrën në fjalë. Aktvendimi i përkohshëm mbeti në fuqi derisa Gjykata Komunale në Viti do të marrë vendim përfundimtar apo deri kur të ndryshohet masa nga gjykata.
12. V.P pretendon se H.L nuk ishte palë në procedurë pranë KKPK-së, dhe kështu, ai sipas nenit 10 dhe 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 *(në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079)*, nuk ka asnjë të drejtë të paraqes ankesë ndaj vendimit të KKPK-së të Gjykatës Supreme. Prandaj, ankesa është e papranueshme.
13. Prona asnjëherë nuk i është shitur H.L nga B.V.P apo S.B.P. Kontrata e supozuar e cila është paraqitur nga H.L, është e rreme.
14. V.P ka fituar të drejtën pronësore ndaj pronës përmes vendimit të trashëgimisë nga gjykata komunale në Viti T.nr. 69/2011 i datës 17 gusht 2011.
15. H.L ka iniciuar procedurë gjyqësore me 7 dhjetor 2012 pranë Gjykatës Komunale në Viti së paku pesë vite pas inicimit të procedurës pranë AKP-së. Prandaj, këtu aplikohet Ligji nr. 03/L-079, sipas nenit 18 i këtij ligji.
16. Pronësia e V.P mbrohen nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe neni 14 i Konventës.

Arsyetim ligjor

Pranueshmëria e ankesës

17. Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën pranë KKPK-së. Kjo rrethanë nuk mund të jetë në dëm të palës ankuese pasi ai me të vërtetë nuk është njoftuar si duhet rreth kërkesës. Njoftimi është bërë përmes publikimit të kërkesës në Gazetën për Njoftime të AKP-së dhe Buletinit të UNHCR-it, dhe njoftimit të lënë në kioskën e fshatit në Viti. Sidoqoftë, kjo përbën “përpjekjet e arsyeshme” për ta bërë njoftimin e kërkesës siç kërkohet me nenin 10.1 të Ligjit nr. 03/L-079, përveç rasteve me përjashtim. Një përjashtim i tillë nuk haset në rastin konkret. Pasi që Gjykata Supreme nuk mund ta përjashtojë faktin se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni, ai duhet të pranohet si palë në procedurën, ku ankesa e tij është e pranueshme. Gjykata i referohet një mori aktgjykimesh lidhur me këtë çështje ndër to edhe GSK-KPA-A-129/12.

Meritat e ankesës

18. Gjykata Supreme fillimisht vëren se është e arsyeshme të merret një aktgjykim në kohën e tashme, edhe pse urdhri i lëshuar nga Gjykata Supreme ende nuk i është dorëzuar V.P. Urdhri është marr më 21 nëntor 2013, dhe mbetet e pasigurt se kur urdhri do t'i dorëzohet asaj. E drejta e palëve për ta pasur në dispozicion një vendim brenda kohës së arsyeshme është një argument i fuqishëm për të marr një aktgjykim tani.
19. Gjithashtu, siç do të arsyetohet më poshtë, Gjykata Supreme e sheh të nevojshme ta anulojë vendimin e KKPK-së dhe ta kthejë prapa në KKPK për rishqyrtim. Kjo do t'i lejojë të dyja palët të bëjnë komentet e tyre në KKPK, dhe në Gjykatë Supreme nëse kundërshtohet vendimi i KKPK-së.
20. Në ankesë, H.L ka deklaruar se ai e ka blerë pronën në vitin 1989, por që transaksioni nuk është regjistruar për shkak të ligjeve diskriminuese që ishin në fuqi në atë kohë. V.P e ka mohuar që një shitblerje e tillë të ketë ndodhur, dhe ka thënë se kontrata e dorëzuar nga H.L është e rreme.
21. Gjykata Supreme nuk posedon prova të mjaftueshme që të vendos në këtë kontest faktik në mes të palëve. Përpjekja për t'i sqaruar faktet e lëndës përmes urdhrin të gjykatës nuk është dëshmuar e efektshme brenda afatit të arsyeshëm. Prandaj, është e nevojshme për Gjykatën

- Supreme ta anulojë vendimin e KKPK-së, dhe ta kthejë lëndën në KKPK për rishqyrtim. Kjo gjithashtu do të mundësojë që lënda të shqyrtohet në dy instanca.
22. Gjatë rishqyrtimit, KKPK-ja do të duhet ta vlerësojë vlefshmërinë e kontratës së dorëzuar, dhe në bazë të këtij vlerësimi të vendos nëse kërkesa është në kompetencë të KKPK-së. Nëse kërkesa është në kompetencë të saj, atëherë KKPK-ja duhet të vendos sipas meritave të lëndës.
23. Në bazë të të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit 03/L-079 dhe nenit 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë ligjore

24. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Gyltene Sylejmani, Gjyqtare

Elka Filcheva Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referenti i EULEX-it